



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM
REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE



UA – 01/2014
31.12.2013

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (në tekstin e mëtutjeshëm: “ZRRUK”),

Në pajtim me autoritetin e dhënë me Nenin 8.4 të Ligjit No. 03/L-086, Për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturive, të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më datë 13 qershor 2008 (në tekstin e mëtutjeshëm: “Ligji”),

Pas konsultimeve me Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe me Ministrinë e Financave që janë zhvilluar gjatë procesit të aprovimit të Buxhetit të ZRRUK për vitin 2014,

Me qëllim të përcaktimit të lartësisë së taksës së licencimit ose metodës së kalkulimit të kësaj takse që është e pagueshme sipas nenit 8 të Ligjit,

Me këtë nxjerrë Udhëzimin Administrativ si vijon:

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Neni 1

Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këtë kuptim:

1.1. “Ofrues i Shërbimeve” Ofruesit e Shërbimeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimit ose Furnizuesit e Ujit me Shumicë, krejt së bashku Ofrues të Shërbimeve, dhe në rast të bashkimit (shkrirjes) të ndonjë Ofruesi të Shërbimeve me një ose më tepër Ofrues të Shërbimeve, pasardhësin e tij.

- 1.2 Përveq nëse ndryshe është perkufizuar me këtë Udhëzim Administrativ, fjalët që fillojnë me shkronjë të madhe do ta kenë kuptimin e që iu është dhënë në Ligj.

Neni 2
Taksa e Aplikimit

Taksa e aplikimit për Licencë të Shërbimit e pagueshme nga një Ofrues i Shërbimeve sipas nenit 8.1 të Ligjit do të jetë €200.00.

Neni 3
Taksa Vjetore e Licencimit

- 3.3. Taksa vjetore e licencimit për vitin që fillon me 1 janar 2014 e pagueshme për Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Nenin 8.2 të Ligjit do të jetë **1.24 %** të faturimit vjetor bruto të atij Ofruesi të Shërbimeve e që është vlera e dhënë në Shtojcën 3, e llogaritur në pajtim me Nenin 8.2 dhe 8.3 të Ligjit si vijon:

$$\mathbf{X = B \times t / T}$$

Ku:

X = Vlera e Taksës Vjetore të Licencimit e pagueshme nga secili Ofrues i Shërbimeve

B = Shpenzimet e parapara të ZRRUK për vitin 2014 (shih Shtojcën 1)

t = Qarkullimi vjetor bruto i Ofruesit të Shërbimeve për vitin paraparak (shih Shtojcën 2)

T = Shuma e qarkullimit vjetor të të gjithë Ofruesve të Licencuar të Shërbimeve në vitin paraparak (shih Shtojcën 3)

- 3.4. Në rast se një Ofrues i Shërbimeve është bashkuar me një apo më tepër Ofrues të Shërbimeve, pasardhësi i tij duhet të paguajë taksën vjetore të licencimit që është e pagueshme nga Ofruesi i Shërbimeve që është bashkuar (shkrirë).
- 3.5. Të gjithë Ofruesit e Shërbimeve te Ujësjellësit dhe Kanalizimit në Kosovë të Licencuar nga ZRRUK janë të obliguar të paguajnë Taksën Vjetore të Licencimit e cila është e ndarë në dymbëdhjetë (12)këste të barabarta në çdo fillim të muajit sipas nenit 8.2 të Ligjit Nr.03/-086.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ do të hyjë në fuqi më 1 janar 2014.



.....
Raif Preteni
Drejtör
Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim

Bashkëqjitur:

Shtojca 1: Shpezimet e Parapara të ZRRUK në 2014

Shtojca 2: Qarkullimi Vjetor i Ofruesve të Shërbimeve në 2012 dhe

Lartësia e Taksës Vjetore të Licencimit për Ofruesit e Shërbimeve për 2014

Shtojca 1.: Shpenzimet Totale të ZRRUK të Parashikuara për vitin 2014

SHPENZIMET TOTALE TË ZRRUK NË 2014	
1. Shpenzimet e Personelit	194,450.00
2. Shpenzimet e Mallërave dhe Shërbimeve	156,900.00
3. Shpenzimet e Shërbimeve Publike	7,650.00
Gjithësejt Shpenzimet e ZRRUK-it:	359,000.00

Shtojca 2: Qarkullimi Vjetor i Ofruesve të Shërbimeve në vitin 2012 të audituar nga ZRRUK si dhe Taksa vjetore e Licencimit per vitin 2014

SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA DHE UJIT ME SHUMICË			TAKSA VJETORE PER OFRUESIT E SHERBIMEVE 2014		
Emri i Ofruesit të Shërbimeve	Regjioni	Qarkullimi bruto vjetor (EUR)	Emri i Ofruesit te Sherbimeve	Regjioni	Lartesia e takses vjetore
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "PRISHTINA"	Prishtina	12,850,310.01	Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "PRISHTINA"	Prishtine	159,278.65
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "BIFURKACIONI"	Ferizaj	1,435,992.33	Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "BIFURKACIONI"	Ferizaj	17,806.30
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "RADONIQI"	Gjakovë	3,155,922.09	Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "RADONIQI"	Gjakove	39,133.43
Ofruesi I Ujit me Shumicë "IBER-LEPENCI"	Prishtinë	384,449.00	Ofruesi I Ujit me Shumicë "IBER-LEPENCI"	Prishtine	4,767.17
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "UJESJELLSI REGJIONAL"	Mitrovicë	2,444,164.39	Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "UJESJELLSI REGJIONAL"	Mitrovice	30,307.64
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDRODRINI"	Pejë	3,109,190.00	Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDRODRINI"	Peje	38,553.96
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDROREGJIONI"	Prizren	3,888,280.37	Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDROREGJIONI"	Prizren	48,214.68
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDROMORAVA"	Gjilan	1,723,340.04	Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDROMORAVA"	Gjilan	21,369.42
Totali – Ofruesit e Ujit dhe Ujërave të Zeza		28,991,648.23	Total taksa vjetore 2014		359.000.00euro

